

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010, Prishtinë), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L -150 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.10 / 03 prill 2017, Prishtinë), nenin 85, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 11 / 11 maj 2012, Prishtinë), nenin 4, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L- 045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 38 / 24 dhjetor 2015, Prishtinë), nenin 23, paragrafi 6, si dhe nenin 66, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18 / 15 qershor 2016, Prishtinë), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE MBI INFORMACIONET QË DUHET TË SHOQËROJNË TRANSFERET E FONDEVE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave të informacioneve mbi pagesin dhe përfituesin që duhet të shoqërojnë transferet e fondeve, në çfarëdo valute, për qëllime të parandalimit, identifikimit dhe investigimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ku së paku njëri nga ofruesit e shërbimeve të pagesave i përfshirë në transferin e fondeve është i licencuar në Kosovë. Kjo rregullore, gjithashtu, përcakton rregullat mbi politikat e brendshme, procedurat dhe kontrollet për të siguruar zbatimin e masave për PPP/LFT ku së paku njëri nga ofruesit e shërbimeve të pagesave i përfshirë në transferin e fondeve është i licencuar në Kosovë.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe degëve të tyre të licencuar në Kosovë, të cilat dërgojnë ose pranojnë transferet e fondeve në çfarëdo valute.
2. Kjo Rregullore nuk zbatohet për transferet e fondeve të realizuara përmes një kartelë pagese, instrumenti i pagesave elektronike, telefon celular apo ndonjë pajisje tjetër teknologjike me parapagim ose me pagesë me karakteristika të ngjashme, me kusht që plotësohen kriteret e mëposhtme:

- 2.1. kartela, instrumenti apo pajisja përdoret vetëm për të paguar mallra dhe shërbime;
- 2.2. numri i kartelës, instrumentit apo pajisjes shoqëron të gjitha transferet që rrjedhin nga transaksioni.
3. Megjithatë, kjo Rregullore zbatohet kur një kartelë pagese, instrument i pagesave elektronike, telefon celular apo ndonjë pajisje tjetër teknologjike me parapagim ose me pagesë me karakteristika të ngjashme përdoret për të realizuar transfer të fondeve ndërmjet personave fizik që veprojnë si konsumator për qëllime të ndryshme nga tregtia, biznesi apo veprimtari profesionale.
4. Kjo Rregullore nuk zbatohet për transferet e fondeve në rastet kur plotësohet njëri nga kriteret e mëposhtme:
 - 4.1. përfshin tërheqjen e parave në të gatshme nga paguesi nga llogaria e pagesës të vet paguesit;
 - 4.2. përbën transfer të fondeve tek një autoritet publik si pagesë për taksa, gjoba ose taksa tjera brenda vendit.
 - 4.3. paguesi dhe përfituesi janë ofrues të shërbimeve të pagesës që veprojnë në emrin e tyre;

Neni 3

Përkufizimet

1. Të gjithë termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm - Ligji për PPP/LFT) dhe Ligjit për shërbimet e pagesave / ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Financim i Terrorizmit** – nënkupton siç është e përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
 - 1.2. **Pastrim i Parave** – nënkupton siç është e përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
 - 1.3. **BQK** – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
 - 1.4. **NJIF-K** – Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës;
 - 1.5. **Paguesi** – nënkupton një person që mban një llogari pagese dhe lejon transferimin e fondeve nga ajo llogari pagese ose, ku nuk ka llogari pagese, që jep një urdhër transferimi fondesh;
 - 1.6. **Përfituesi** – nënkupton një person që është pranues i synuar i transferimit të fondeve;
 - 1.7. **Ofrues i shërbimit të pagesave - OSHP** – nënkupton çdo institucion financiar të licencuar, regjistruar ose autorizuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për të ofruar shërbimet e transferit të fondeve;
 - 1.8. **Ofrues i shërbimit të pagesave ndërmjetësues** – nënkupton një OSHP që nuk është OSHP i paguesit ose përfituesit dhe që merr dhe transmeton një transferim fondesh në emër të OSHP të paguesit ose të përfituesit ose të një OSHP tjetër ndërmjetësues;
 - 1.9. **Llogari e pagesës** – nënkupton një llogari të mbajtur në emër të një ose më shumë përdoruesve të shërbimit të pagesave e cila përdoret për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave;
 - 1.10. **Fonde** – nënkupton kartëmonedha dhe monedha, para të gatshme ose para elektronike;

- 1.11. **Transfer i fondeve** - nënkupton çdo transaksion të kryer të paktën pjesërisht me mjete elektronike në emër të një paguesi përmes një OSHP, me synimin për t'i vënë fonde të disponueshme te përfituesi, pavarësisht nëse paguesi dhe përfituesi janë persona të njëjtë dhe pavarësisht nëse OSHP e paguesit dhe ajo e përfituesit janë një dhe të njëjtë, duke përfshirë:
- 1.11.1. transfer i kreditit;
 - 1.11.2. debitim direkt;
 - 1.11.3. dërgesa parash (remitanca);
 - 1.11.4. transfer i kryer duke përdorur një kartelë pagese, instrument i pagesave elektronike, telefon celular ose një pajisje tjetër elektronike me parapagim ose me pagesë me karakteristika të ngjashme;
- 1.12. **Transfer i fondeve në grup përmes fajllit** – nënkupton një grup të disa transfereve individuale të fondeve të bashkuara për transmetim;
- 1.13. **Identifikues unik i transaksionit** – nënkupton një kombinim shkronjash, numrash ose simbolesh të përcaktuara nga OSHP, në përputhje me protokollet e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve ose sistemeve të mesazheve të përdorura për transferimin e fondeve, gjë që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit mbrapa tek paguesi dhe përfituesi;
- 1.14. **SEPA** – nënkupton Zonën Unike të Pagesave në Euro;
- 1.15. **Identifikues i personit juridik** – nënkupton një kod unik i bazuar në standardin ISO 17442 i caktuar një personi juridik.
- 1.16. **Dërgesa parash (remitanca)** – nënkupton një shërbim pagese ku fondet merren nga një pagues, pa hapur ndonjë llogari pagese në emër të paguesit ose përfituesit të pagesës, me qëllimin e vetëm të transferimit të një shume korresponduese tek një pranues ose një ofrues tjetër i shërbimit të pagesave që vepron në emër të përfituesit të pagesës dhe/ose kur këto fonde merren në emër të dhe vihen në dispozicion të përfituesit të pagesës.

KAPITULLI II

DETYRIMET PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE

Seksioni I

Detyrimet për ofruesit e shërbimit të pagesave të paguesit

Neni 4

Informacioni shoqërues i transfereve të fondeve

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, duhet të sigurojë që transferi i fondeve shoqërohet me informacionet e mëposhtme të paguesit:
 - 1.1. emrin e paguesit;
 - 1.2. numrin e llogarisë së pagesës së paguesit;
 - 1.3. adresën e paguesit duke përfshirë emrin e vendit, numrin personal të dokumentit zyrtar të identifikimit dhe numrin e identifikimit të klientit ose datën dhe vendin e lindjes;

2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, duhet të sigurojë që transferi i fondeve shoqërohet me informacionet e mëposhtme të përfituesit:
 - 2.1. emrin e përfituesit;
 - 2.2. numrin e llogarisë së pagesës së përfituesit;
3. Me përjashtim të nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1, dhe nënparagrafit 2.2 të paragrafit 2 të këtij neni, në rastin e një transferi që nuk është bërë në ose nga një llogari pagese, ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit duhet të sigurojë që transferi i fondeve është i shoqëruar nga një identifikues unik i transaksionit.
4. Përpara transferimit të fondeve, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet të verifikojë saktësinë e informacionit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni dhe, kur është e zbatueshme, në paragrafin 3 të këtij neni, në bazë të dokumenteve, të dhënave ose informacionit të marrë nga një burim i besueshëm dhe i pavarur.
5. Verifikimi i përmendur në paragrafin 4 të këtij neni do të konsiderohet se është kryer kur zbatohet një nga sa vijon:
 - 5.1. Identiteti i paguesit është verifikuar në përputhje me dispozitat e kujdesit të duhur ndaj klientit siç janë të përcaktuara në Ligjin për PPP/LFT dhe informacioni i marrë në bazë të atij verifikimi është ruajtur në përputhje me dispozitat e nenit 64 të Ligjit për PPP/LFT.
 - 5.2. Dispozitat e paragrafit 1.4 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT zbatohen për paguesin.
6. Pa cenuar përjashtimet e parashikuara në nenet 5 dhe 6, ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit nuk do të kryejë asnjë transfer fondesh përpara se të sigurojë pajtueshmërinë e plotë me këtë nen.

Neni 5

Transferet e fondeve brenda vendit

1. Duke përjashtuar paragrafët 1 dhe 2 të nenit 4, ku të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfshira në zinxhirin e pagesave të cilët veprojnë në Kosovë, transferet e fondeve duhet të shoqërohen nga së paku numri i llogarisë së pagesës si të paguesit ashtu edhe të përfituesit ose, kur zbatohet paragrafi 3 i nenit 4, identifikuesi unik i transaksionit.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, ofruesit e shërbimeve të pagesave të paguesit, brenda tre ditëve të punës nga marrja e një kërkesë për informacion nga ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfituesit ose nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ndërmjetësues, duhet të vërë në dispozicion sa vijon:
 - 2.1. për transferet e fondeve mbi vlerën 1,000 euro, nëse këto transfere realizohen në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione që duket se janë të lidhura, informacionin mbi paguesin ose përfituesin në përputhje me nenin 4;
 - 2.2. për transfertat e fondeve që nuk kalojnë vlerën prej 1,000 euro që nuk duket se janë të lidhura me transfere të tjera fondesh të cilat, së bashku me transferin në fjalë, kalojnë vlerën prej 1,000 euro, të paktën:
 - 2.2.1. emrat e paguesit dhe përfituesit;
 - 2.2.2. numrat e llogarisë së pagesës të paguesit dhe të përfituesit ose, kur zbatohet paragrafi 3 i nenit 4, identifikuesin unik të transaksionit.

3. Me përjashtim të paragrafit 4 të nenit 4, në rastin e transfereve të fondeve të përmendura në paragrafin 2.2 të këtij neni, ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit nuk ka nevojë të verifikojë informacionin mbi paguesin, përveç rasteve kur ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit:
 - 3.1. ka marrë fondet për t'u transferuar në para në të gatshme ose në para elektronike anonime; ose
 - 3.2. ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim parash ose financim terrorizmi.

Neni 6

Transferet e fondeve jashtë vendit

1. Në rastin e transfereve të fondeve në grup përmes fajllit nga një pagues i vetëm, ku ofruesit e shërbimit të pagesave të përfituesve janë jashtë vendit, paragrafi 1 i nenit 4 nuk do të zbatohet për transferet e fondeve individuale të grupuara së bashku, me kusht që fajlli i grupit të përmbajë informacionin e referuar në paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 4, se ai informacion është verifikuar në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 të nenit 4, dhe se transferet individuale mbajnë numrin e llogarisë së pagesës së paguesit ose, kur paragrafi 3 i nenit 4 zbatohet, identifikuesin unik të transaksionit.
2. Me përjashtim nga paragrafi 1 i nenit 4 dhe, kur është e zbatueshme, pa paragjykuar informacionin e kërkuar në përputhje me Rregulloren e BQK-së mbi vendosjen e kërkesave teknike dhe të biznesit për transfertat e kredisë dhe debitimet direkte në euro, fondet që nuk kalojnë shumën prej 1,000 euro e që nuk duket se janë të lidhura me transfere të tjera fondesh të cilat së bashku me transferin në fjalë tejkalojnë shumën prej 1,000 euro, duhet të shoqërohen së paku nga:
 - 2.1. emrat e paguesit dhe të përfituesit
 - 2.2. numrat e llogarisë së pagesës të paguesit dhe përfituesit ose kur zbatohet paragrafi 3 i nenit 4, identifikuesin unik të transaksionit.
3. Me përjashtim të paragrafit 4 të nenit 4, ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit nuk ka nevojë të verifikojë informacionin për paguesin e përmendur në këtë paragraf, përveç nëse ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit:
 - 3.1. ka marrë fondet për t'u transferuar në para në të gatshme ose në para elektronike anonime; ose
 - 3.2. ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim parash ose financim terrorizmi.

Seksioni II

Detyrimet për ofruesit e shërbimit të pagesave të përfituesit

Neni 7

Zbulimi i informacionit që mungon mbi paguesin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit do të zbatojë procedura efektive për të zbuluar nëse fushat në lidhje me informacionin mbi paguesin dhe përfituesin në sistemin e mesazheve ose pagesave dhe shlyerjeve të përdorura për të realizuar transferin e fondeve janë plotësuar duke përdorur karaktere ose inpute të pranueshme në përputhje me konventat e atij sistemi.

2. Ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit do të zbatojë procedura efektive, duke përfshirë, sipas rastit, monitorimin pas ose gjatë transfereve të fondeve, me qëllim që të zbulohet nëse informacioni i mëposhtëm për paguesin ose përfituesin mungon:
 - 2.1. për transferet e fondeve ku ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit është i vendosur brenda vendit, informacionin e përmendur në nenin 5;
 - 2.2. për transferet e fondeve ku ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit është jashtë vendit, informacioni i përmendur në nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të nenit 4, dhe në nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 të paragrafit 2 të nenit 4;
 - 2.3. për transferet e fondeve në grup përmes fajllit ku ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit është vendosur jashtë vendit, informacioni i përmendur në nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të nenit 4, dhe në nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 të paragrafit 2 të nenit 4.
3. Në rastin e transfereve të fondeve që tejkalojnë shumën prej 1,000 euro, nëse këto transfere realizohen si një transaksion i vetëm ose në disa transaksione që duket se janë të lidhura, përpara se të kreditohet llogaria e pagesës së përfituesit ose t'i vërë fondet në dispozicion të përfituesit, ofruesi i shërbimeve të pagesës së përfituesit duhet të verifikojë saktësinë e informacionit për përfituesin e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni në bazë të dokumenteve, të dhënave ose informacionit të marrë nga një burim i besueshëm dhe i pavarur, si dhe nëse është e rregulluar me legjislacionin në vend pa cenuar kërkesat e parashikuara sa i përket kohës së ekzekutimit dhe datës së vlefshmërisë së transaksionit.
4. Në rastin e transfereve të fondeve jo më shumë se 1,000 euro që nuk duket se janë të lidhura me transfere të tjera fondesh, të cilat, së bashku me transferin në fjalë, kalojnë shumën prej 1,000 euro, ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit nuk ka nevojë të verifikojë saktësinë e informacionit mbi përfituesin, përveç nëse:
 - 4.1. ndikon në pagesën e fondeve në para në të gatshme ose në para elektronike anonime; ose
 - 4.2. ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit.
5. Verifikimi i përmendur në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni do të konsiderohet i kryer kur zbatohet një nga sa vijon:
 - 5.1. Identiteti i përfituesit është verifikuar në përputhje me dispozitat e kujdesit të duhur ndaj klientit siç janë të përcaktuara në Ligjin për PPP/LFT dhe informacioni i marrë në bazë të atij verifikimi është ruajtur në përputhje me dispozitat e nenit 64 të Ligjit për PPP/LFT.
 - 5.2. Dispozitat e paragrafit 1.4 të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT zbatohen për përfituesit.

Neni 8

Transferet e fondeve me informacion të munguar ose jo të plotë mbi paguesin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit duhet të zbatojë procedura efektive të bazuara në rrezik, duke përfshirë procedurat e bazuara në elementin e ndjeshëm ndaj rrezikut për të përcaktuar nëse duhet ekzekutuar, refuzuar ose të pezullojë një transfer fondesh pa informacionin e plotë të kërkuar të paguesit dhe përfituesit dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura përcjellëse.
 - 1.1. Kur ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit vihet në dijeni, kur pranon një transfer të fondeve, se informacioni i përmendur në nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 dhe

nënparagrafët 2.1 dhe 2.2, të paragrafit 2 të nenit 4, paragrafi 1 i nenit 5, dhe nenin 6, mungon ose nuk është i plotë ose nuk është plotësuar duke përdorur karaktere ose inpute të pranueshme në përputhje me konventat e sistemit të mesazheve ose pagesave dhe shlyerjeve siç përmendet në paragrafin 1 të nenit 7, ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit, mbi një bazë të ndjeshme ndaj rrezikut duhet të :

1.1.1. refuzojë transferin e fondeve; ose

1.1.2. kërkojë informacionin e kërkuar për paguesin dhe përfituesin përpara ose pas kreditimit të llogarisë së pagesës së përfituesit ose vënies së fondeve në dispozicion të përfituesit.

2. Kur një ofrues i shërbimit të pagesave në mënyrë të përsëritur dështon të sigurojë informacionin e kërkuar për paguesin ose përfituesin, ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit duhet:

2.1. të ndërmarrë hapa, të cilët fillimisht mund të përfshijnë lëshimin e paralajmërimeve dhe caktimin e afateve, përpara se të vazhdohet me refuzimin, kufizimin ose përfundimin në përputhje me nënparagrafin 2.2 të këtij neni nëse informacioni i kërkuar ende nuk është dhënë; ose

2.2. refuzojë drejtpërdrejt çdo transfer të ardhshëm të fondeve nga ai ofrues i shërbimit të pagesave ose kufizon apo përfundon marrëdhëniet e saj të biznesit me atë ofrues të shërbimit të pagesave.

3. Në bazë të paragrafit paraprak, ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit duhet t'i raportojë BQK-së dhe NJIF-K këtë dështim, dhe hapat e ndërmarrë. Përgjithësisht, në rastet e raportimit sipas nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT, ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit duhet të zbatojë dispozitat e përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT.

Neni 9

Vlerësimi dhe Raportimi

Ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit duhet të marrë në konsideratë informacionin e munguar ose jo të plotë mbi paguesin ose përfituesin si një faktor kur vlerëson nëse një transferim fondesh, ose ndonjë transaksion i lidhur, është i dyshimtë dhe nëse ai duhet të raportohet në NjIF-K në përputhje me Ligjin për PPP/LFT.

Seksioni III

Detyrimet për ofruesit e shërbimit të pagesave ndërmjetësues

Neni 10

Ruajtja e informacionit mbi paguesin dhe përfituesin që shoqëron transferimin

Ofruesit ndërmjetësues të shërbimeve të pagesave duhet të sigurojnë që i gjithë informacioni i marrë për paguesin dhe përfituesin që shoqëron një transfer të fondeve të ruhet me transferin.

Neni 11

Zbulimi i informacionit që mungon mbi pagesin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimit të pagesave ndërmjetësues duhet të zbatojë procedura efektive për të zbuluar nëse fushat në lidhje me informacionin mbi pagesin dhe përfituesin në sistemin e mesazheve ose pagesave dhe shlyerjeve të përdorura për të realizuar transferin e fondeve janë plotësuar duke përdorur karaktere ose inpute të pranueshme në përputhje me konventat e atij sistemi.
2. Ofruesi i shërbimit të pagesave ndërmjetësues duhet të zbatojë procedura efektive, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, monitorimin pas ose gjatë transferit të fondeve, për të zbuluar nëse informacioni i mëposhtëm për pagesin ose përfituesin mungon:
 - 2.1. për transferet e fondeve ku ofruesit e shërbimit të pagesave të pagesit dhe të përfituesit janë të vendosura brenda vendit, informacioni i përmendur në nenin 5;
 - 2.2. për transferet e fondeve ku ofruesi i shërbimit të pagesave të pagesit ose të përfituesit është themeluar jashtë vendit, informacioni i përmendur në nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1, dhe në nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 të paragrafit 2 të nenit 4;
 - 2.3. për transferet e fondeve në grup përmes fajllit ku ofruesi i shërbimit të pagesave të pagesit është vendosur jashtë vendit, informacioni i përmendur në nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1, dhe në nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 të paragrafit 2 të nenit 4.

Neni 12

Transferet e fondeve me informacion të munguar mbi pagesin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetësues duhet të vendosë procedura efektive të bazuara në rrezik për përcaktimin nëse do të ekzekutohet, refuzohet ose pezullohet një transferim fondesh që i mungojnë informacionet e kërkuara të pagesit dhe të pagesit dhe për marrjen e masave të duhura përcjellëse.
2. Kur ofruesi i shërbimit të pagesave ndërmjetësues vihet në dijeni, kur pranon një transfer të fondeve, se informacioni i përmendur në nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 dhe nënparagrafët 2.1 dhe 2.2, të paragrafit 2 të nenit 4, paragrafi 1 i nenit 5, ose nenin 6, mungon ose nuk është i plotë ose nuk është plotësuar duke përdorur karaktere ose inpute të pranueshme në përputhje me konventat e sistemit të mesazheve ose pagesave dhe shlyerjeve siç përmendet në paragrafin 1 të nenit 7, ofruesi i shërbimit të pagesave ndërmjetësues, mbi një bazë të ndjeshme ndaj rrezikut duhet të :
 - 2.1. refuzojë transferin;
 - 2.2. kërkojë informacionin mbi pagesin dhe përfituesin para apo pas transmetimit të transferit të fondeve.
3. Kur një ofrues i shërbimit të pagesave në mënyrë të përsëritur dështon të japë informacionin e kërkuar për pagesin ose përfituesin, ofruesi i shërbimit të pagesave ndërmjetësues duhet:
 - 3.1. të ndërmarrë hapa, të cilët fillimisht mund të përfshijnë lëshimin e paralajmërimeve dhe caktimin e afateve, përpara se të vazhdohet me refuzimin, kufizimin ose përfundimin në përputhje me nënparagrafin 3.2 të këtij neni nëse informacioni i kërkuar ende nuk është dhënë; ose

- 3.2. refuzojë drejtpërdrejt çdo transfer të ardhshëm të fondeve nga ai ofrues i shërbimit të pagesave ose kufizon apo përfundon marrëdhëniet e saj të biznesit me atë ofrues të shërbimit të pagesave.
- 3.3. Në bazë të paragrafit paraprak, ofruesi i shërbimit të pagesave ndërmjetësues duhet t'i raportojë BQK-së dhe NJIF-K këtë dështim, dhe hapat e ndërmarrë. Përfundimisht, në rastet e raportimit sipas nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT, ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit duhet të zbatoj dispozitat e përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT.

Neni 13

Vlerësimi dhe Raportimi

Ofruesi i shërbimit të pagesave ndërmjetësues duhet të marrë në konsideratë informacionin e munguar ose jo të plotë mbi pagesin ose përfituesin si një faktor kur vlerëson nëse një transferim fondesh, ose ndonjë transaksion i lidhur, është i dyshimtë dhe nëse ai duhet të raportohet në NJIF-K në përputhje me Ligjin për PPP/LFT.

Seksioni IV

Zbatimi i masave kufizuese

Neni 14

Politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme për të siguruar zbatimin e masave parandaluese

Ofruesit e shërbimit të pagesave të duhet të kenë politika, procedura dhe kontrolle të brendshme për të siguruar zbatimin e masave të PPP/LFT sipas ligjit në fuqi ose rregullores së BQK-së gjatë kryerjes së transfereve të fondeve sipas kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI III

INFORMACIONI, MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE

Neni 15

Mbrojtja e të dhënave

1. Përpunimi i të dhënave personale sipas kësaj Rregulloreje i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Të dhënat personale do të përpunohen nga ofruesit e shërbimit të pagesave në bazë të kësaj Rregulloreje vetëm për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe nuk do të përpunohen më tej në mënyrë të papajtueshme me këto qëllime. Përpunimi i të dhënave personale në bazë të kësaj Rregulloreje për qëllime komerciale është rreptësisht i ndaluar.
3. Ofruesit e shërbimit të pagesave do t'u ofrojnë klientëve të rinj informacionin e kërkuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale përpara se të krijojnë një marrëdhënie biznesi ose të kryejnë një transaksion të rastit. Ky informacion do të jepet në një formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të qasshme në përputhje me dispozitat

e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, në veçanti, do të përfshijë një njoftim të përgjithshëm në lidhje me detyrimet ligjore të ofruesit të shërbimit të pagesave sipas kësaj Rregulloreje kur përpunojnë të dhëna personale për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4. Ofruesit e shërbimit të pagesave duhet të sigurojnë gjithmonë që transmetimi i çdo të dhëne personale për palët e përfshira në transferimin e fondeve të kryhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 16

Ruajtja e të dhënave

1. Ofruesit e shërbimit të pagesave të paguesit dhe të përfituesit do të ruajnë të dhënat e informacionit të përmendur në nenet 4 deri në 7, për një periudhë prej pesë vjetësh.
2. Pa paragjykuar paragrafin në vijim, pas skadimit të periudhës së ruajtjes të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, ofruesit e shërbimit të pagesave do të sigurojnë që të dhënat personale të fshihen, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj.
3. BQK-ja mund të lejojë ose të kërkojë mbajtje të mëtejshme për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh pasi të ketë kryer një vlerësim të plotë të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të një mbajtjeje të tillë të mëtejshme, dhe kur e konsideron të nevojshme për parandalimin, zbulimin ose hetimin e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Neni 17

Bashkëpunimi me autoritetet tjera

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet BQK-së dhe autoriteteve të tjera vendase dhe të huaja me kompetenca në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit do t'i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për PPP/LFT.

KAPITULLI IV

NDËSHKIMET ADMINISTRATIVE DHE MASA PËR PËRMIRËSIM

Neni 18

Dispozitat e përgjithshme

1. Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do jenë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese siç përcaktohet me Ligjin për PPP/LFT, Ligjin për Bankën Qendrore dhe Legjislacionin përkatës për institucionet financiare.
2. BQK-ja do të mbikëqyrë institucionet financiare në aspektin e pajtueshmërisë me detyrimet sipas Ligjit për PPP/LFT, Rregullores për PPP/LFT dhe kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI V
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19
Dispozita kalimtare

Afati për zbatimin e plotë të dispozitave të kësaj Rregulloreje është 31 dhjetor 2024.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me 1 gusht 2024.

Bashkim Nurboja
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës